

E RËNDËSISHME:



Nëse nëna e fëmijës është shtetase e huaj, dhe nuk është e martuar (e kurorëzuar) me babain, shpesh herë punëtorët e administratës në zyrën e gjendjeve civile kërkojnë të dorëzoni një dokument nga vendi amë për historinë martesore të nënës.



Nëse nëna e fëmijës gjatë kohës kur është lindur fëmija ka qenë e martuar (e kurorëzuar) me një person tjetër që nuk është babai biologjik i fëmijës dhe martesa nuk është prishur (nuk është divorcuar), me pajtueshmëri ai duhet të regjistrohet si baba i fëmijës sipas Ligjit për Familjen edhe pse ai nuk është babai biologjik i fëmijës, kurse pastaj atësia e babait biologjik të vërtetë të dëshmohet me procedurë gjyqësore.

Mosregjistrimi i fëmijëve në regjistrin e të lindurve sjell pasoja serioze edhe për prindin edhe për fëmijën. Si pasojë e kësaj, fëmijëve shpesh nuk u lejohej të shkojnë në shkollë, të bëjnë vizita shëndetësore te një mjek, të punësohen, të hapin llogari në bankë, të sigurojnë strehim (banesë) apo të sigurojnë edhe një martesë. Personat pa shtetësi hasin në vështirësi në qasjen e të drejtave themelore të tyre, në mesin të cilave edhe e drejta e arsimit, e drejta e shëndetësisë, e drejta e punësimit dhe e drejta e lirisë të lëvizjes. Nëse kjo qasje është e kufizuar, ata përballen me pengesa dhe zhgënjime gjatë gjithë jetës, shpesh duke ngelur edhe pa shtetësi tërë jetës.

**MOS LEJONI
KJO TË NDODH!**



Nëse keni nevojë për ndihmë juridike falas për procedurat për regjistrim të fëmijës në Zyrën e Gjendjes Civile së të lindurve (librin amzë së të lindurve) ose për atë, që ju e keni të paqartë në këtë broshurë, ju lutemi na kontaktoni në adresat e mëposhtme dhe numrat e telefonit:

SHOQATA MAQEDONASE E JURISTËVE TË RINJ

Rr: Donbas Nr.14/61000 Shkup
(Ул. Донбас бр.14/61000 Скопје)
Debar Maallo, ndërtesa Nastel, pas Vardar Mebel
Telefoni: **02 3220 870** dhe

Rr/Brigada Kosovare Maqedonase nr.17/2
(Shuto Orizari, përballë Marketit Kiper)
Telefoni: **02 2655 844**

www.myla.org.mk

contact@myla.org.mk

[younglawyersmacedonia](https://www.facebook.com/younglawyersmacedonia)

[myla_mzmp](https://www.instagram.com/myla_mzmp)



M3MP

**PROCEDURA PËR
REGJISTRIM**
në regjistrin amzë
së të lindurve





Regjistrimi në regjistrin amzë së të lindurve së një fëmije të lindur në spital:

Nëse je prind i fëmijës së sapolindur, që ka lindur në spital dhe i cili duhet të regjistrohet në regjistrin amzë së të lindurve dhe ta marrë certifikatën e parë nga regjistri amzë i të lindurve është e nevojshme të veprësh si në vijim:

- Ta kontaktosh Zyrën e Gjendjes Civile në komunën/lagjen ku ka lindur fëmija për ta regjistruar lindjen e fëmijës dhe për t'i vënë emrin personal, jo më vonë se 60 ditë (dy muaj) nga dita e lindjes.
- T'i dorëzoni dokumentet në vijim:
 - Letërnjoftim të dy prindërve të fëmijës. Do t'i dorëzoni kopjet, ndërsa origjinalet vetëm do t'i tregoni për t'i parë.
 - Certifikata e martesës (kurorëzimit) së prindërve (kopje), ndërsa nëse nuk jeni të martuar, kopje nga certifikatat e lindjes së prindërve.
 - Kopje të kartonit të spitalit të nënës si vërtetim se ajo e ka lindur fëmijën. Originalin e kartonit vetëm do ta tregoni, por nuk do ta dorëzoni te zyra e regjistrimeve se ai duhet të ngel tek ju.
 - Të paguani tarifë administrative prej 50 denarë dhe pagesë prej 100 denarë për certifikatë nga regjistri amzë i të lindurve, që mund ta paguani në sportelin, por vetëm me kartë bankare debitore ose kreditore.
 - Të plotësoni një kërkesë, të cilën e merrni në zyrën e gjendjes civile.



Regjistrimi i një fëmije të lindur në kushte shtëpiake brenda afatit ligjor:

Nëse je prind i fëmijës që është i lindur në shtëpi, e nevojshme është fëmijën menjëherë ta regjistrosh në regjistrin amzë së të lindurve në Zyrën e Gjendjes Civile në komunën, në territorin ku ka lindur fëmija, për të cilin duhet të paraqisni një kërkesë dhe dokumentet e mëposhtme:

- Letërnjoftim të dy prindërve të fëmijës. Do t'i dorëzoni kopjet, ndërsa origjinalet vetëm do t'i tregoni për t'i parë.
- Certifikata e martesës (kurorëzimit) së prindërve (kopje), a nëse nuk jeni të martuar, kopje nga certifikatat e lindjes së prindërve.
- Të paguani tarifë administrative prej 50 denarë dhe pagesë prej 100 denarë për certifikatë nga regjistri amzë i të lindurve, që mund ta paguani në sportelin, por vetëm me kartë bankare debitore ose kreditore.
- Të plotësoni një kërkesë, të cilën e merrni në Zyrën e Gjendjes Civile.
- Regjistrimi ose paraqitjen e lindjes së fëmijës duhet ta bësh në afat më të vonshëm prej 30 ditëve nga dita e lindjes së fëmijës.



E

RËNDËSISHME:



Në raste kur regjistrohet fëmijë / person i lindur në spital, pas kalimit të afatit ligjor të regjistrimi prej 60 ditë, dorëzohen dëshmitë e njëjta si në rastin e mëparshëm, vetëm paguhen edhe 250 denarë më tepër në emër të tarifës administrative për regjistrim shtesë në regjistrin amzë së të lindurve dhe 150 denarë tarifë për certifikatën nga Regjistri Amzë i të Lindurve.



Regjistrimi në regjistrin amzë së të lindurve së një fëmije/person të lindur në kushte shtëpiake pas kalimit të afatit prej 30 ditë:

Nëse je prind i një fëmije që ka lindur në kushte shtëpiake dhe nuk është regjistruar në regjistrin amzë së të lindurve brenda afatit ligjor prej 30 ditëve nga lindja ose ti je personi që je lindur në kushte shtëpiake dhe nuk je regjistruar në regjistrin amzë së të lindurve, e nevojshme është t'i dorëzosh dokumentet në vijim në zyrën kompetente të regjistrimit së të lindurve sipas vendit (komunës) ku ke lindur:

- Letërnjoftim të dy prindërve të fëmijës. Do t'i dorëzoni kopjet, ndërsa origjinalet vetëm do t'i tregoni për t'i parë.
- Certifikata e martesës (kurorëzimit) së prindërve (kopje), ndërsa nëse nuk jeni të martuar, kopje nga certifikatat e lindjes së prindërve.
- Procesverbali i vaksinave të marra, por nëse fëmija nuk ka marrë asnjë vaksinë, dorëzoni një deklaratë të notarizuar nga prindërit e fëmijës se fëmija nuk ka pranuar vaksina dhe përse nuk ka pranuar. Në të shumtën e rasteve nga shërbimet e regjistrimeve kërkohet të parashtrohet edhe një vërtetim nga pediatri për moshën e fëmijës.
- Në raste të veçanta, më së shpeshti nëse fëmija (personi) është më i vjetër, Zyra e Gjendjes Civile kompetente mund të kërkojnë të bëni analizën e ADN-së për ta vërtetuar lidhjen e gjakut të prindërve dhe fëmijës. Këto dëshmi dorëzoni vetëm nëse ju kërkohen nga ana e një shërbyesi administrativ nga zyra e regjistrimeve të lindjes. Shpenzimet për analizën e ADN-së variojnë nga 18 000 denarë deri në 30 000 denarë për një fëmijë dhe përgatiten në disa laboratorë. MANU. Mjekësi Ligjore dhe SINLAB. Analiza e ADN-së që të përgatitet nëna e fëmijës duhet të ketë letërnjoftim ose pasaportë ose leje qëndrimi për të huaj, që ta dëshmojë identitetin e vet.
- Nëse fëmija/personi që do të regjistrohet në regjistrin amzë së të lindurve ka ndjekur shkollimin, personi administrativ i regjistrimeve në Zyrën e Gjendjes Civile mund të kërkojë të dorëzoni certifikatën e arsimit të përfunduar. Nëse nuk ka ndjekur asnjë shkollë, zakonisht kërkohet deklaratë e notarizuar nga të dy prindërit e fëmijës se fëmija e tyre nuk e ka ndjekur shkollimin (nuk është arsimuar).